


## Ndërtesa të parafabrikuara në Tiranë



*e verdhë* - ndërtesa të parafabrikuara *e kuqe* - ndërtesa informale *blu* - ndërtesa me tulle të kuqe/të bardhë

Njësitë e banimit të parafabrikuara (me panele të parapregatitura) mund të kategorizohen në katër module që janë mjaft të ngjashëm në skemë dhe elemente ndërtimi. Këto module kanë dy mure anësorë kallkan, të cilët bashkëngjiten duke i kombinuar në skema lineare. Modulet lidhëse me sistemin konstruktiv të betonit dhe muret me tullë përdoren për bashkimin këndor të dy ndërtesave.

Kjo mundësonte një larmi më të madhe zgjidhjesh urbane dhe arkitektonike, si dhe fleksibilitet në projektim, pa nevojën e krijimit të seksioneve të veçanta, që do të kërkonin prodhimin e llojeve të reja të pllakave të parafabrikuara. Lartësia e ndërtesave varion përgjithësisht nga pesë në gjashtë kate, me një lartësi kati prej 280cm. Skema e organizimit të seksionit të ndërtesës përbëhet nga një nyje qarkullimi vertikale, ku është vendosur blloku i shkallëve, rreth të cilave janë të organizuara dy ose tre apartamente. Nyja e qarkullimit përbëhet nga dy shkallë dhe dy sheshpushime; njëri sheshpushim lejon hyrjen në apartamentet e katit, ndërsa sheshpushimi i katit të ndërmjetëm ka pamje të drejtpërdrejtë në fasadë. Kjo tipologji ndërtesash ka një nivel të lartë humbjeje të energjisë për shkak të izolimit të dobët termik, infiltrimit, amortizimit dhe mungesës së mirëmbajtjes. Për shkak të kondensimit ose mungesës së materialeve poroze, shpesh në këtondërtesa ka lagështi. Pikat e lidhjeve të paneleve të betonit, si dhe dritaret e

dyert, janë më kritiket. Gjithashtu shtresa e jashtme e fasadës karakterizohet nga humbje termike relativisht të larta, në të gjithë perimetrin e saj. Si rezultat i kësaj performance të dobët termike, nivelet e rehatisë në shtëpitë e ndërtesave të parafabrikuara janë problematike dhe kërkojnë përdorim të lartë të energjisë për të pasur kushte të mira jetese. Sigurisht, gjendja e tyre ndikon në standardin e jetesës dhe shëndetin e banorëve dhe për këtë arsye mundësia për ndërhyrje në këto struktura duhet konsideruar si një përparësi.

Meqenëse këto struktura nuk e kanë përbushur akoma ciklin e tyre të jetës dhe kostot e shembjes dhe rindërtimit të tyre do të ishin të papërbalueshme për ekonominë vendore, skenari i rehabilitimit shihet si mundësia realiste më e përshtatshme, që mund të ndikojë në zgjidhjen e problemit të ndërtesave të parafabrikuara; si dhe në përmirësimin tërësor të standardeve minimale të jetesës në vend.

Humbjet e larta termike si dhe prania e lagështisë janë dy nga problemet më serioze të ndërtesave të parafabrikuara. Ndër tipologjitë e banesave kolektive, ndërtesat e parafabrikuara padyshim ofrojnë standardet më të ulëta të rehatisë dhe performancë të dobët në lidhje me konsumin e energjisë. Njëkohësisht, panelet prej betoni ofrojnë mundësi minimale ndërhyrjeje për të përshtatur planet e apartamenteve, për shkak të përbërjes së materialit si edhe rolit të tyre strukturor.

## **Referenca**

SLED "Tipologjia e stokut të ndërtesave të banimit në Shqipëri dhe modeli i shndërrimit të tyre për shkarkime të ulta karboni në të ardhmen. Mbështetje për zhvillimet me shkarkime të ulëta karboni në Evropën JugLindore"

Islami, G. (2016). Përmirësimi i performancës energjetike në banesat me panele të parapërgatitura në Tiranë. Tiranë.

Mazniku, G. (2020). Energy Poverty and Energy Retrofit Measures in Housing Stock: Case of Tirana. Tiranë.